



**GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT**

Nr. 29 regjistër (JR)
Datë 28.05.2021

Nr. 41 i vendimit
Datë 30.07.2024

**VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i përbërë nga gjyqtarët:

Rezarta Schuetz	Kryesuese
Sokol Çomo	Relator
Ina Rama	Anëtare
Natasha Mulaj	Anëtare
Albana Shtylla	Anëtare

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike, më datë 30.07.2024, ora 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në Tiranë, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Steven Kessler, me Sekretare Gjyqësore Anisa Sejдини, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit nr. 29/2021 (JR), datë 28.05.2021, që i përket:

ANKUES: Komisioneri Publik Florian Ballhysa.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 352, datë 01.03.2021, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Iliba Bezati.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, nenet C, pika 2 dhe F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës; neni 63 i ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore publike, me praninë e palëve, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe

prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), dëgjoi Komisionerin Publik, i cili përfundimisht kërkoi ndryshimin e vendimit nr. 352, datë 01.03.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për subjektin e rivlerësimit, znj. Iliba Bezati, dhe shkarkimin e saj nga detyra, bazuar në nenin 61, pikat 3 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016, dëgjoi subjektin e rivlerësimit, znj. Iliba Bezati, e cila përfundimisht kërkoi lënien në fuqi të vendimit objekt shqyrtimi, dëgjoi gjyqtarin relator të çështjes Sokol Çomo, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Iliba Bezati, prej vitit 1998 e në vijim, ka ushtruar detyrën e gjyqtare dhe, në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, ushtronte detyrën e gjyqtare në Gjykatën e Apelit Vlorë. Për rrjedhojë, në zbatim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës, ajo iu nënshtrua procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio*.
2. Subjekti i rivlerësimit ka plotësuar dhe dërguar pranë institucioneve kompetente dhe brenda afatit ligjor¹, në përputhje me nenet 31, pika 1, 35, pika 1 dhe 41, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, përkatësisht deklaratën e pasurisë², deklaratën për kontrollin e figurës³, si dhe formularin për vetëvlerësimin profesional⁴.
3. Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), pasi kreu procedurën e kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, në zbatim të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, dërgoi pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, duke konstatuar se:
 - (i) Deklarimi nuk është i saktë, në përputhje me ligjin.
 - (ii) Nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë.
 - (iii) Ka kryer fshehje të pasurisë.
 - (iv) Ka kryer deklaram të rremë.
 - (v) Bashkëshorti i subjektit ka përfituar të ardhura në kushtet e konfliktit të interesave.
4. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”) kreu kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit kishte kontakte të papërshtatshme me personat e

¹Afati ligjor, prej 30 ditësh nga hyrja në fuqi e ligjit për dorëzimin e deklaratës së pasurisë, kontrollit të figurës dhe formularit të vetëvlerësimit profesional, ka përfunduar më datë 31.01.2017.

²Dorëzuar pranë ILDKPKI-së më datë 30.01.2017, sipas vërtetimit të ILDKPKI-së me nr. {***} prot., datë 30.01.2017. Të njëjtën datë mban dhe deklarata e pasurisë në rubrikën përkatëse.

³Referuar “Deklaratës për kontrollin e figurës”, dorëzimi është kryer më datë 26.01.2017.

⁴Dorëzuar pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë më datë 26.01.2017, sipas procesverbalit të mbajtur për këtë qëllim më datë 26.01.2017.

përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016, dhe dërgoi një raport pranë Komisionit, bazuar në nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, me anë të të cilit konstatoi përshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit për vazhdimin e detyrës. Në datën 19.12.2019, DSIK-ja ka dërguar një raport të dytë të përditësuar, në të cilin ka ndryshuar konstatimin fillestar të dhënë për subjektin e rivlerësimit, nga përshtatshmëri për vazhdimin e detyrës, në papërshtatshmëri në vazhdimin e detyrës nga subjekti i rivlerësimit, znj. Iliba N. Bezati.

5. Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim “KLGj”) ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit nëpërmjet rishikimit të dokumenteve ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt rivlerësimi, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe të 5 dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv e rastësor, dhe ka dërguar pranë Komisionit një raport të hollësishëm për subjektin e rivlerësimit, bazuar në nenin 43 të ligjit nr. 84/2016.
6. Bazuar në nenin Ç, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 4 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, pasi administroi raportet e vlerësimit të hartuara për subjektin e rivlerësimit, znj. Iliba Bezati, nga ILDPKI-ja, DSIK-ja dhe KLGj-ja, kreu procesin e rivlerësimit kalimtar bazuar në të tria kriteret e vlerësimit (vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale), duke marrë vendimin nr. 352, datë 01.03.2021.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

7. Komisioni, me vendimin nr. 352, datë 01.03.2021, vendosi: “Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Iliba Bezati, gjyqtare në Gjykatën e Apelit Vlorë [...]”.
8. Ky vendim është marrë bazuar në nenet 58, pika 1, shkronja “a” dhe 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, në vijim të konkluzioneve të mëposhtme për secilin prej tri kriterëve të rivlerësimit.

8.1 Në lidhje me vlerësimin e pasurisë së subjektit – në përfundim, duke e vlerësuar kriterin e pasurisë për këtë subjekt rivlerësimi, në tërësinë e tij dhe nën dritën e parimit të proporcionalitetit dhe të objektivitetit, trupi gjykues çmon se pamjaftueshmëria financiare e sipërpërmendur, në vlerën totale 607.922 lekë, duke mbajtur në vëmendje sa është shprehur në paragrafin e fundit (nr. 158) të pasurisë nr. 12, si dhe faktin që kjo mangësi financiare është e shpërndarë në vite – sikurse pasaktësitë e konstatuara në deklaratimet e subjektit, nuk përbëjnë shkaqe të mjaftueshme për aplikimin e masës së shkarkimit nga detyra të znj. Iliba Bezati, sipas parashikimeve të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe/ose të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016. Për rrjedhojë, trupi gjykues vlerëson se znj. Iliba Bezati ka arritur një nivel të besueshëm në lidhje me kriterin e pasurisë, duke justifikuar dhe shpjeguar bindshëm të gjitha pasuritë e analizuara.

8.2 Në lidhje me kontrollin e figurës – në përfundim dhe për rrjedhojë të sa është konstatuar, përshkruar dhe arsyetuar më lart, trupi gjykues mbërrin në konkluzionin se përgjatë hetimit administrativ, të kryer në mënyrë të pavarur nga Komisioni, nuk kanë rezultuar informacione apo fakte që mund të cenojnë figurën e subjektit të rivlerësimit, znj. Iliba Bezati, apo elemente të tjera

të mjaftueshme që, në vetvete, të mund të përbënin shkak për shkarkimin e subjektit të rivlerësimit, në zbatim të pikës 2 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

8.3 *Në lidhje me vlerësimin e aftësive profesionale – nga kryerja e një vlerësimi të përgjithshëm të kriterit të aftësive profesionale, trupi gjyqësor çmon se, nisur nga gjendja faktiko-ligjore e konstatuar dhe e argumentuar më lart, si dhe nga konstatimet lidhur me mënyrën e të punuarit (modus operandi) të subjektit, nuk kanë rezultuar problematika që mund të klasifikohen si shkelje apo mangësi të rënda profesionale të subjektit të rivlerësimit. Për rrjedhojë, në konkluzion, trupi gjyqësor çmon se, nisur nga rrethanat e sipërpërshkruara, subjekti i rivlerësimit, znj. Iliba Bezati, ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimeve të nenit 44/a të ligjit nr. 84/2016.*

III. Shkaqet e ankimit

9. Komisioneri Publik Florian Ballhysa, më datë 05.05.2021, ushtroi ankim ndaj vendimit të Komisionit nr. 352, datë 01.03.2021, për subjektin e rivlerësimit, znj. Iliba Bezati, duke pretenduar se përfundimet e arritura nga Komisioni për konfirmimin e saj në detyrë, nuk bazohen në një hetim të gjithanshëm, të plotë dhe shterues për subjektin e rivlerësimit dhe personat e lidhur me të. Sipas Komisionerit Publik, Kolegji duhet të riçelë hetimin gjyqësor, pasi rezulton se hetimi i Komisionit nuk ka qenë shterues në drejtim të identifikimit të burimeve të ligjshme të krijimit të të ardhurave, të personave të tjerë të lidhur me subjektin e rivlerësimit, të ardhura që kanë shërbyer për krijimin e pasurive mbi të cilat ushtron të drejta subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të. Komisioneri Publik shprehet në ankimin e tij, se vlerësimi i çështjeve të verifikuara gjatë rivlerësimit të kriteve përkatëse të subjektit të rivlerësimit, znj. Iliba Bezati, duhet të kryhet bazuar edhe në jurisprudencën e pritshme orientuese të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, për çështje të ngjashme që janë në fazën e shqyrtimit gjyqësor nga Kolegji në kohën e ushtrimit të këtij ankimi, duke iu referuar çështjes së regjistruar në Kolegj, bazuar në ankimin e tij kundër vendimit të Komisionit nr. 161/2019.
10. Ankimi i Komisionerit Publik ndaj vendimit të Komisionit nr. 352, datë 01.03.2021, ushtrohet për të tria kriteret e rivlerësimit. Sipas Komisionerit Publik, referuar gjendjes së fakteve dhe provave, nuk krijohet bindja se subjekti i rivlerësimit arrin nivel të besueshëm për konfirmimin në detyrë. Për rrjedhojë, Komisioneri Publik kërkoi nga Kolegji, marrjen në shqyrtim të shkaqeve të sipërcituara të ankimit, çeljen e hetimit gjyqësor dhe, në përfundim të gjyqimit, në zbatim të nenit 66 të ligjit nr. 84/2016, që të vendosë:
 - *Lënien në fuqi të vendimit nr. 352, datë 01.03.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.*
 - Ose:*
 - *Ndryshimin e këtij vendimi.*
11. Shkaqet e ankimit për kriterin e vlerësimit të pasurisë, paraqiten në mënyrë të përmblëdhur si më poshtë.

11.1. *Lidhur me pasuritë e paluajtshme të llojit “apartament banimi”, me sipërfaqe 82 m² në Vlorë dhe “apartament banimi” me sipërfaqe totale 121,6 m², me vendndodhje në Tiranë,* Komisioneri Publik kërkoi verifikimin e rrethanave faktike dhe juridike lidhur me të ardhurat që rrjedhin nga dhurimet, të përdorura si burim për krijimin e pasurive të sipërcituara, si dhe interpretimin ligjor, bazuar edhe në jurisprudencën e pritshme të Kolegjit, referuar çështjes së rivlerësimit të subjektit K. S.

11.2. Komisioneri Publik kundërshtoi si të paarsyetuar përfundimin e arritur nga ana e Komisionit, lidhur me vlerësimin e tij mbi verifikimin e burimeve të ligjshme të z. J. H., për të dhënë hua shumë prej 30.000 eurosh, të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit si burim për blerjen e apartamentit të banimit në Tiranë.

11.3. *Në lidhje me analizën financiare të kryer nga Komisioni për periudhën e rivlerësimit 2003-2016,* Komisioneri Publik pretendoi se, referuar edhe vlerësimit të Kolegjit mbi çështjet e mësipërme, duket se lind nevoja e rivlerësimit sipas metodologjisë së përdorur nga Kolegji në jurisprudencën e deritanishme, të zërave përbërës të analizës financiare të kryer nga Komisioni, si: (i) “Kursime të vitit/cash, të padepozituara në asnjë bankë”; (ii) “Të ardhura të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit” e “Të ardhura të subjektit të rivlerësimit”; (iii) “Shpenzime jetese” për vitin 2007; dhe (iv) “Shpenzime udhëtimi”.

- 12.** Shkaqet e ankimit në lidhje me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, parashtrohen në mënyrë të përmbledhur si më poshtë.

12.1. *Në lidhje me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale,* Komisioneri Publik, duke iu referuar shqyrtimit nga Komisioni të ankesës nr. {***} prot., datë 24.06.2014 (të përmendur në raportin e organit ndihmës në kapitullin “Të dhëna arkivore të KLD-së”, informacion nga kryetarja e Gjykatës së Apelit Vlorë, mbi cenimin e vendimit nr. 181, datë 19.09.2013, të Gjykatës së Apelit Vlorë, me vendimin nr. 339, datë 18.12.2013, të Gjykatës së Lartë), pretendon se, nga përmbajtja e vendimit të Komisionit, konstatohet se mungon qëndrimi i këtij të fundit në lidhje me pretendimet e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit në raport me përmbajtjen e dispozitave të neneve 245-249 të Kodit të Procedurës Penale, referuar edhe vendimit të ndërmjetëm, datë 18.06.2013, që ka marrë vetë trupa gjyquese e Gjykatës së Apelit Vlorë.

IV. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

A. Mbi aspektet procedurale të gjykimit

a) Juridiksioni i Kolegjit

- 13.** Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji ka juridiksion (*ratione materiae*) ndaj ankimeve kundër vendimeve të Komisionit lidhur me rivlerësimin e subjekteve, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës.

Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, i cili ka vendosur për rivlerësimin e subjektit të rivlerësimit, znj. Iliba Bezati, duke e konfirmuar atë në detyrë, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

b) Legjitimimi i Komisionerit Publik si ankues

14. Komisioneri Publik legjitimohet *ratione personae* në kuptim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neneve C, pika 2 dhe F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, dhe *ratione temporis* pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh⁵ nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

c) Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit

15. Në përputhje me nenin 65, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, ankimi kundër vendimit të Komisionit, i ushtruar nga Komisioneri Publik, shqyrtohet në seancë publike. Për rrjedhojë, edhe çështja objekt gjykimi, u mor në shqyrtim nga Kolegji në seanca gjyqësore publike, të zhvilluara në prani të palëve në datat 03.06.2024, 26.06.2024, 19.07.2024, 25.07.2024 dhe 30.07.2024.
16. Në vijim të kërkesës së Komisionerit Publik për riçeljen e hetimit gjyqësor, si dhe rishikimin e zërave të analizës financiare të Komisionit, sipas pretendimeve të paraqitura në ankimin e tij dhe gjatë parashtrësive në Kolegj, si dhe të kërkesës së subjektit të rivlerësimit drejtuar trupit gjykues për riçeljen e hetimit gjyqësor dhe administrimin si provë shkresore të akteve të depozituara gjatë parashtrimeve në Kolegj, trupi gjykues, pasi dëgjoi shpjegimet e palëve, në funksion të shqyrtimit të çështjes, me vendim të ndërmjetëm⁶, bazuar në nenin F, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenet 45, 49, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016, vendosi:
- (i) Çeljen e hetimit gjyqësor, duke marrë në cilësinë e provës aktet e individualizuara nga subjekti i rivlerësimit në seancën gjyqësore të datës 26.06.2024.
 - (ii) Me shumicë votash, trupi gjykues vendosi t’i kërkojë Komisionerit Publik të përcaktojë se cilat konkluzione konkrete të Komisionit, lidhur me zërat e analizës financiare të kryer për subjektin e rivlerësimit, kundërshton, si dhe efektin financiar që paraqesin këta zëra në vlerësimin përfundimtar të kësaj analize.
17. Në zbatim të vendimit të mësipërm të trupit gjykues, Komisioneri Publik depozitoi në Kolegj më datë 03.07.2024, parashtrimet e tij me shkrim, të përgatitura në zbatim të detyrës së lënë nga trupi

⁵ Siç rezultoi nga aktet e administruara në fashikullin gjyqësor, vendimi i Komisionit nr. 352, datë 01.03.2021, për rivlerësimin e subjektit, znj. Iliba Bezati, i është njoftuar Institucionit të Komisionerit Publik më datë 24.04.2021, me shkresën nr. {***} prot., të së njëjtës datë, kurse ankimi i Komisionerit Publik është depozituar pranë Komisionit me shkresën nr. {***} prot., datë 05.05.2021, protokolluar në Komision me nr. {***} prot., datë 05.05.2021, që rezultojn të jetë dita e 15-të e afatit ligjor për të ushtruar ankim në përputhje me nenin 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016.

⁶ Shih procesverbalin e seancës gjyqësore të datës 26.06.2024.

gjykues në seancën gjyqësore publike të datës 26.06.2024, të cilat iu përcollën edhe subjektit të rivlerësimit, znj. Iliba Bezati, duke i dhënë mundësinë asaj të njihej me zërat e analizës financiare të Komisionit, të kundërshtuara nga Komisioneri Publik, dhe efektin e tyre në vlerësimin përfundimtar të analizës së kryer për periudhën e rivlerësimit 2003-2016, si dhe duke u mundësuar palëve t'i debatonin ato në seancë gjyqësore publike.

18. Lidhur me denoncimet e publikut të përcjella në Kolegj nga Komisioneri Publik pas dorëzimit të ankimit, pasi dëgjoji palët në seancën gjyqësore të datës 19.07.2024, në konsideratë edhe të qëndrimit të Komisionerit Publik se në vlerësimin e tij këto denoncime nuk përmbanin shkaqe nga ato të parashikuara nga neni 53 i ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vendosi të mos hetojë lidhur me to.

B. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë, në aspektin e konstatimit të drejtë të situatës faktike dhe zbatimit të ligjit material

19. *Lidhur me pasuritë e paluajtshme të llojit “apartament banimi” me sipërfaqe 82 m², në Vlorë, si dhe “apartament banimi” me sipërfaqe totale 121,6 m², me vendndodhje në Tiranë, për të cilat Komisioneri Publik kërkoi verifikimin e rrethanave faktike dhe juridike lidhur me të ardhurat që rrjedhin nga dhurimet të përdorura si burim për krijimin e pasurive të sipërcituara, si dhe interpretimin ligjor bazuar edhe në jurisprudencën e pritshme të Kolegjit, referuar çështjes së rivlerësimit të subjektit K.S., trupi gjykues konstatoi sa më poshtë.*
20. Komisioni, në kontrollin dhe vlerësimin e këtyre dy pasurive, në përfundim të procesit të rivlerësimit, ka konkluduar mbi ligjshmërinë e krijimit të tyre dhe mjaftueshmërinë e deklaramentit të subjektit të rivlerësimit lidhur me to, duke arsyetuar në vendim në mënyrë të përmbledhur, përkatësisht si vijon.
 - Sa i përket pasurisë së paluajtshme “apartament banimi” me sip. 82 m² në Vlorë: [...] *Lidhur me vërtetësinë dhe mjaftueshmërinë e deklaramentit të subjektit për pasurinë në Vlorë, me sipërfaqe 82 m², trupi gjykues vlerëson se mospërputhja ndërmjet deklaratës së vitit 2003 dhe asaj vetting, mbi vlerën e pasurisë në fjalë, është shpjeguar bindshëm [...]. Lidhur me pretendimin se mbi të ardhurat e përfituara nga vjehrra e subjektit, në shitjen e pasurisë së paluajtshme në vitin 1997, nuk duhet të zbritet tatim, trupi gjykues vlerëson se nga një analizë e legjislacionit tatimor në fuqi në momentin e transaksionit të lartpërmendur, rezulton se sipas Dekretit nr. 1673, datë 20.12.1996, [...] për çmimin e shitjes mbi 6.000.000 lekë, detyrimi tatimor përkatës ka qenë 3% e çmimit, shumë kjo e cila i është zbritur nga llogaritja e të ardhurave të vjehrrës së subjektit në analizën financiare.*
 - Lidhur me pasurinë e paluajtshme “apartament banimi” me sip. 121,6 m² në Tiranë, Komisioni, në konkluzion të hetimit administrativ, i ka komunikuar subjektit të rivlerësimit se personat e tjerë të lidhur, shtetasit O. B. dhe M. B., kanë pasur burime të ligjshme financiare për të justifikuar dhurimin e shumës prej 2.700.000 lekësh në favor të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, për blerjen e apartamentit në fjalë, duke konstatuar si gjetje të vetme mos të provuarin e pagesës së tatimit për të gjitha shitjet e pasurive që kanë shërbyer për krijimin e kësaj shume.

Edhe për burimin tjetër të krijimit të pasurisë objekt kontrolli, huanë në vlerën 30.000 euro, të marrë nga personi tjetër i lidhur, z. J. H., Komisioni ka konkluduar se ky i fundit ka pasur burime të ligjshme financiare për dhënien e huasë, me burim të ligjshëm nga mjetet monetare të shoqërisë. Në përfundim të procesit të rivlerësimit, Komisioni, lidhur me gjetjen mbi pagesën e detyrimeve tatimore mbi të ardhurat e realizuara nga shitja e pasurive të paluajtshme nga dhuruesit, ka konkluduar: *Lidhur me pagesën e tatimeve mbi shumat e realizuara nga shitja e pasurive të paluajtshme, përpos shpjegimeve dhe provave të paraqitura nga subjekti, trupa gjyqësore çmon se, nisur nga përmbajtja e dispozitave ligjore dhe nënligjore në periudhat përkatëse, konstatohet se legjislacioni në fuqi [...] parashikonte se: “Zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të hipotekës nuk regjistrojnë kalimin e pronësisë pa u paraqitur dokumenti që vërteton pagimin e tatimit të parashikuar në paragrafin e parë të këtij neni”.* Nisur nga kjo dispozitë, për sa kohë, në rastin konkret, është provuar regjistrimi i pasurive të shitura në emër të palëve blerëse, kryerja e pagesave të detyrimeve tatimore duhet të konsiderohet e realizuar plotësisht dhe paraparakisht këtij veprimi deklarativ. Në përfundim, Komisioni ka vlerësuar se nuk konstatohen problematika lidhur me këtë pasuri.

21. Komisioneri Publik i kundërshtoi si të pabazuara konkluzionet e Komisionit lidhur me pasuritë objekt kontrolli, me pretendimin se hetimi administrativ ka qenë i paplotë në drejtim të verifikimit të burimeve të ligjshme të personave të tjerë të lidhur, burime që kanë shërbyer për krijimin e pasurive në pronësi apo në posedim të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me subjektin, deklaruar kryesisht në formën e dhurimeve ndër vite. Sipas Komisionerit Publik, në rastet e shumave të deklaruara si të dhuruara nga personat e tjerë të lidhur, Komisioni, në kuadër të vlerësimit të këtyre të ardhurave si të ardhura të ligjshme në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, rezultoi të ketë realizuar një interpretim ligjor, si në lidhje me konsiderimin e burimit të krijimit të këtyre shumave, ashtu edhe në lidhje me konsiderimin e ligjshmërisë së tyre, lidhur me pagesën e detyrimeve tatimore.
22. Komisioneri Publik pretendoi fillimisht në ankimin e tij, se, për dy pasuritë e sipërcituara, ku vlera e të ardhurave të deklaruara me burim dhurimet nga znj. M. B., shkon në shumën 8 milionë lekë, Komisioni, në vendimin e tij, ka analizuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të të ardhurave, duke iu referuar më së shumti veprimeve juridike të lejuara nga ligji (kontrata shitjeje) për tjetërsimin e pronësisë së pasurive të paluajtshme, ku dhuruesja, znj. M. B., ka qenë në cilësinë e shitëses, ndërkohë që në lidhje me pagesën e detyrimeve tatimore që rrjedhin nga dhurimi i këtyre shumave, duke iu referuar argumentimit të Komisionit në vendim, ky i fundit nuk ka konstatuar dhe arsyetuar nëse dhurimet duhet të jenë ose jo në mesin e të ardhurave që përjashtohen nga pagesat e detyrimeve tatimore. Komisioneri Publik parashtroi në ankim se verifikimi i kriterëve ligjore në lidhje me vlerësimin e ligjshmërisë së dhurimeve të vlerave monetare, ishte pjesë e një tjetër ankimi të ushtruar nga Komisioneri Publik ndaj vendimit të Komisionit për një tjetër subjekt rivlerësimi, në rastin e të cilit Komisioneri Publik, bazuar edhe në rekomandimin e ONM-së, kishte kërkuar nga Kolegji orientim për zgjidhjen e çështjeve të ngjashme.

23. Gjatë gjykimit të çështjes në Kolegj, Komisioneri Publik, gjatë fazës së paraqitjes së parashtrimeve lidhur me shkaqet e ankimit, u shpreh: *Në lidhje me shkakun ankimor mbi ligjshmërinë e burimeve të shumave të deklaruar të përfituara “në formën e dhurimeve nga persona të tjerë të lidhur” (prindërit e bashkëshortit në rastin konkret), trajtuar në paragrafin 14.1 e vijues në ankimin e datës 5.5.2021, Komisioneri Publik paraprakisht vlerëson të nënvizojë evoluimin e jurisprudencës së Kolegjit, për sa kërkuar mbi verifikimin e ligjshmërisë së shumës së dhuruar sipas kërkesës së nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës. Kolegji tashmë ka interpretuar në jurisprudencën e tij orientuese, verifikimin e burimit të ligjshmërisë së shumave të dhuruara, parë kjo e fundit në raport me pagimin e tatimit për to. Në të tilla rrethana, orientimi i dhënë nga Kolegji duket se ezauron këtë shkak të ankimit.*
24. Ndodhur në këto kushte, trupi gjykues, në konsideratë edhe të parashikimeve të nenit 463 të Kodit të Procedurës Civile, vlerësoi se konkluzionet e Komisionit lidhur me vlerësimin e ligjshmërisë së vlerave të dhuruara nga prindërit e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, të përdorura dhe të deklaruar si burim për krijimin e dy pasurive të paluajtshme objekt kontrolli sipas këtij shkaku ankimi, mbeten të pacenuara.
25. Komisioneri Publik kundërshtoi gjithashtu si të paarsyetuar edhe përfundimin e arritur nga ana e Komisionit lidhur me vlerësimin e tij mbi verifikimin e burimeve të ligjshme të z. J. H. për të dhënë hua “me burim të ligjshëm nga mjetet monetare të shoqërisë”, shumën prej 30.000 eurosh, të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit si burim për blerjen e apartamentit të banimit në Tiranë. Këtë pretendim të paraqitur në ankimin e tij, Komisioneri Publik e bazoi në faktin se Komisioni nuk ka arsyetuar në vendim konkluzionin e arritur si më sipër, në raport me përmbajtjen e korrespondencës së tij me Drejtorinë Rajonale Tatimore⁷ dhe QKB-në, sipas të cilave konfirmohet se fitimi i deklaruar nga ky subjekt tregtar për vitet 1994-1996, ka qenë në shumën totale prej 572.180 lekësh; për vitet 1997-2004, subjekti tregtar ka deklaruar vetëm xhiro vjetore; ndërsa për vitet 2005-2006, subjekti ka deklaruar të ardhura, por nuk ka depozituar bilanc fizik në dosje.
26. Referuar pretendimeve të Komisionerit Publik në ankim, në gjendjen që ishin aktet në fashikullin e përcjellë nga Komisioni, mbetej i paprovuar konkluzioni i Komisionit se, për dhënien e huasë nga personi tjetër i lidhur, z. J. H., kishin shërbyer mjetet monetare të shoqërisë tregtare “{***}” ShPK, për sa kohë gjatë hetimit administrativ, sipas tij, nuk u dokumentua raportimi dhe pasqyrimi i kësaj vlere monetare në ndonjë akt financiar kontabël të kësaj shoqërie, sipas legjislacionit të zbatueshëm. Gjithashtu, edhe vendimi i ortakëve të shoqërisë “{***}” ShPK, i datës 11.01.2005, i depozituar nga subjekti gjatë hetimit administrativ në Komision, sipas Komisionerit Publik, duhet të merret me rezervë, për sa kohë nuk rezultoi që ky vendim të ishte depozituar në QKB dhe se subjekti nuk provoi as pasqyrimin e kësaj huaje në akte të tjera kontabël të shoqërisë në fjalë. Ndërsa, sa i takon kontratës mbi shitjen e një pasurie të huadhënësit në vitin 1998, pretenduar si burim për dhënien e huasë, Komisioneri Publik pretendoi se ajo nuk arrinte të provonte burimin e

⁷ Sipas shkresës së Drejtorisë Rajonale Tatimore Vlorë me nr. {***} prot., datë 15.01.2020.

pretenduar, për sa kohë të ardhurat në këtë kontratë, në vlerën e 1.950.000 lekëve, ishin më të ulëta se huaja e dhënë, në shumën prej 30.000 eurosh.

27. Në kundërshtim të këtij shkaku ankimi, subjekti i rivlerësimit, znj. Iliba Bezati, në parashtrimet e saj para Kolegjit, prapësoi se Komisioni ka arsyetuar në mënyrë të qartë për mundësinë financiare për dhënien e huasë nga mjetet monetare të shoqërisë tregtare “{***}” ShPK në situatën faktike të provuar se, gjatë vitit 2005, për periudhën janar – tetor, nga llogaritë bankare të shoqërisë janë debituar vlerat monetare që mbulojnë vlerën e huasë së dhënë në formën e tërheqjeve *cash*. Në mbështetje të sa më sipër, subjekti i rivlerësimit pretendoi se shoqëria tregtare “{***}” ShPK ishte subjekt tregtar me përgjegjësi tatimore “tatim i thjeshtuar mbi fitimin”, përgjegjësi e cila llogaritej bazuar në xhiron e deklaruar në fillim të vitit nga vetë subjektet tregtare.
28. Subjekti i rivlerësimit parashtroi para Kolegjit se, në lidhje me pretendimin e Komisionerit Publik se gjatë hetimit nuk u dokumentua raportimi dhe pasqyrimi i vlerës së huasë në ndonjë akt financiar kontabël të shoqërisë, sipas legjislacionit në fuqi, i ishte drejtuar Drejtorisë Rajonale Tatimore Vlorë (në vijim “DRT Vlorë”) për marrjen e një informacioni dhe interpretimi juridik nëse subjektet me përgjegjësi tatimore “tatim i thjeshtuar mbi fitimin”, kanë pasur apo jo detyrim ligjor të depozitojnë pasqyrat financiare pranë administratës tatimore në vitet 2004, 2005, 2006. Sipas subjektit, referuar përgjigjes së DRT-së Vlorë⁸, e cila u administrua nga trupi gjykues si provë e re në proces, shoqëria “{***}” ShPK, duke qenë se ishte subjekt tregtar me përgjegjësi të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin, kishte vetëm detyrim të dorëzonte deklaratën për xhiron e parashikuar dhe jo akte kontabël, ku të gjenin pasqyrim, në rastin konkret, huatë, të cilat në rastin e tatimpaguesve me përgjegjësi tatimore “tatim mbi fitimin”, evidentohen në aktet kontabël. Subjekti pretendoi gjithashtu se ajo dhe bashkëshorti i saj nuk kanë qenë në dijeni të faktit që huadhënësi, si administrator i një subjekti tregtar, nuk ka pasur detyrim për të dorëzuar balancë, llogari analitike apo pasqyra financiare të shoqërisë dhe, për rrjedhojë, ka qenë në pamundësi objektive për të siguruar për efekt të këtij procesi, dokumentacion kontabël që do të pasqyronte dhënien e borxhit nga shoqëria tek ortakut (huadhënësi). Sa i takon pretendimit për mospasqyrim në QKB të vendimit të asamblesë së ortakëve të shoqërisë “{***}” ShPK në vitin 2005, subjekti prapësoi se në vitin 2005, kur është marrë vendimi i asamblesë për dhënie huaje ortakut, regjistri tregtar për shoqëritë tregtare mbahej nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në referencë të dispozitave ligjore të kohës⁹ dhe se, referuar këtyre dispozitave, nuk parashikohej që në regjistrin tregtar, të regjistrohej apo depozitohet çdo vendim që merrte asambleja e ortakëve, por vetëm ato që kishin të bënin me ndryshime statutore, shtimin, pakësimin e objektit të veprimtarisë së shoqërisë, kohëzgjatjen e saj etj.
29. Në fazën e bisedimeve përfundimtare, Komisioneri Publik, lidhur me këtë shkak të ankimit mbi zërin “Hua në vlerën 30.000 euro”, mbajti qëndrimin se, pas vlerësimit të prapësimeve të subjektit të rivlerësimit dhe akteve të depozituara gjatë hetimit gjyqësor në Kolegj, si dhe në kuadër të

⁸ Sipas shkresës së Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Vlorë nr. {***} prot., datë 25.06.2024.

⁹ Neni 13 i ligjit nr. 7632, datë 04.11.1992, “Për disa dispozita që rregullojnë pjesën e parë të Kodit Tregtar”, si dhe ligji nr. 7667, datë 28.1.1993, “Për regjistrin tregtar dhe formalitetet që duhen respektuar nga shoqëritë tregtare”.

evoluimit të jurisprudencës së Kolegjit në raste të ngjashme mbi detyrimin e subjekteve në drejtim të verifikimit të mundësisë financiare të huadhënësve, referuar rrethanave konkrete, mangësitë e konstatuara në ankim lidhur me dokumentimin e plotë të rrethanave faktike për kalimin e shumës së deklaruar si të marrë hua nga z. J. H., nuk ngarkojnë me përgjegjësi subjektin e rivlerësimit.

30. Ndodhur në kushtet e mësipërme, si konstatoi heqjen dorë të Komisionerit Publik nga shkaku i ankimit lidhur me verifikimin e ligjshmërisë së shumës prej 30.000 eurosh të marrë hua, trupi gjykues arriti në të njëjtin përfundim si më sipër, se konkluzioni i Komisionit edhe në këtë rast, mbeti i pacenuar.
31. *Lidhur me shkakun e ankimit të Komisionerit Publik për rivlerësimin sipas metodologjisë së përdorur nga Kolegji në jurisprudencën e deritanishme të disa zërave përbërës të analizës financiare të kryer nga Komisioni, për periudhën e rivlerësimit 2003-2016, trupi gjykues konstatoi dhe vlerësoi si vijon.*
32. Në mbështetje të këtij shkaku ankimi, Komisioneri Publik, në zbatim edhe të detyrës së lënë nga trupi gjykues në seancën gjyqësore të datës 26.06.2024, për përcaktimin e konkluzioneve konkrete të Komisionit, të kundërshtuara prej tij nëpërmjet ankimit, në lidhje me zërat e analizës financiare të periudhës së rivlerësimit, 2003 – 2016, dhe efektin financiar që ato japin në vlerësimin përfundimtar të kësaj analize, pretendoi se:

32.1. *Lidhur me zërin “Kursime ndër vite”, kryerja e analizës financiare nga ana e Komisionit, bazuar në pretendimet e subjektit të rivlerësimit lidhur me kursimet e deklaruar në deklaratat periodike vjetore 2010-2016, nuk mbështetet dhe as përputhet me mënyrën e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit për vitet 2005-2009, ku subjekti ka deklaruar saktësisht shumat e kursyera dhe vendndodhjen e tyre, në bankë. Komisioneri Publik pretendoi se më së paku për vitin 2013, kursimet e subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur me të duhet të llogariten sipas deklarimeve në deklaratën periodike të këtij viti, në të cilën specifikohet: *kursime të vitit 2013, në vlerën 2.440.000 lekë*. Komisioneri Publik pretendoi se, nisur nga paqartësitë/kontradiktat në mënyrën e deklarimit dhe ndarjes midis kursimeve (në llogaritë bankare dhe në *cash*) apo dhe identifikimit nëse kursimet *cash* të deklaruar janë gjendje në fund të vitit apo kursime shtesë të vitit, vlerësohet se pretendimi i subjektit gjatë hetimit administrativ, në përgjigje të pyetësorit nr. 5 të Komisionit, dhe përlllogaritja e kursimeve të vitit 2013, sipas këtij pretendimi, nuk gjen mbështetje në deklaratën periodike të vitit 2013, në jurisprudencën e Kolegjit mbi kursimet në *cash*, si dhe në ligjin e zbatueshëm. Komisioneri Publik shprehet se, edhe nëse merret në konsideratë ky pretendim i subjektit të rivlerësimit, duke përfshirë në analizën financiare për vitin 2013, si kursim në *cash* (gjendje) vetëm shumën prej 777.207 lekësh (si *diferencë e shumës së kursimeve të deklaruar prej 2.440.000 lekësh dhe shumës gjendje në llogaritë rrjedhëse bankare të subjektit dhe personit të lidhur me të, prej 1.662.793 lekësh*), përsëri do të rezultonte pamjaftueshmëri e burimeve të ligjshme të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur për të mbuluar shpenzimet dhe kursimet e këtij viti, në shumën e 500.010 lekëve. Sipas Komisionerit Publik, sa më sipër, do të ndikonte edhe në burimet e depozitës së deklaruar në deklaratën periodike të vitit 2014 në emër të*

bashkëshortit të subjektit në FiBank, në shumën e 2.500.000 lekëve, me burim të deklaruar: [...] nga kursimet e vitit 2013, në shumën 2.440.000 lekë.

32.2. Lidhur me zërin “Të ardhura të subjektit dhe bashkëshortit”, Komisioneri Publik kundërshtoi përlllogaritjen e këtij zëri të ardhurash nga Komisioni, sa u takon të ardhurave të bashkëshortit të subjektit të krijuara me burim:

(i) *Të ardhurat nga paga dhe honorarë për vitet 2005, 2009 dhe 2010.* Komisioneri Publik pretendoi se, nga verifikimet e kryera prej tij, ka konstatuar mospërputhje mes të ardhurave të konfirmuara nga Universiteti “{***}”, Vlorë¹⁰, me aktet e tjera në dosje, si: deklaratimet e subjektit të rivlerësimit mbi të ardhurat e deklaruar të bashkëshortit në deklaratat periodike vjetore, si dhe totalin e të ardhurave të deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting*; aktet mbi të ardhurat e bashkëshortit në Universitetin “{***}”, Vlorë, të dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit në ILDKPKI; listëpagesat e detajuara dhe konfirmimin mbi të ardhurat për honorarët e bashkëshortit, dorëzuar nga subjekti bashkëlidhur përgjigjeve të pyetësorit nr. 3 të Komisionit. Sipas Komisionerit Publik, të ardhurat për vitet 2009 dhe 2010, sipas shkresës së institucionit arsimor, janë kryesisht kreditime në llogari me përshkrimin: “Dieta, udhëtime jashtë shtetit” dhe, si të tilla, referuar jurisprudencës së Kolegjit, sipas Komisionerit, nuk duhet të përlllogariten dhe të përfshihen në zërin e të ardhurave. Me rezervë, sipas tij, duhet të konsiderohen edhe të ardhurat e konfirmuara në formën e honorarëve për vitin 2005.

(ii) *Të ardhurat nga qiradhënia e apartamentit të banimit në Tiranë për vitet 2011-2015 dhe të ardhurat nga shitja e librit të bashkëshortit në vitin 2011,* për të cilat detyrimet tatimore përkatëse rezultojnë të jenë paguar më datë 24 janar 2017, nga llogaria e bashkëshortit të subjektit pranë BKT-së. Komisioneri Publik pretendoi se, referuar edhe jurisprudencës së Kolegjit, në raste të ngjashme¹¹, këto të ardhura për të cilat detyrimet tatimore janë paguar në janar të vitit 2017, rreth 6 vite më pas dhe pak ditë para dorëzimit të deklaratës *vetting*, nuk përmbushin standardin e të ardhurës së ligjshme në kuptim të nenit D, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 3, pika 19 e ligjit nr. 84/2016 dhe, si të tilla, nuk duhet të përfshihen në zërin e të ardhurave, duke ndikuar përkatësisht edhe rezultatin financiar për vitet 2011-2015, sipas analizës së dorëzuar prej tij bashkëlidhur parashtimeve.

32.3. Lidhur me zërin “Shpenzime”, Komisioneri Publik pretendoi se në analizën e kryer nga Komisioni për vitin 2007, shpenzimet e jetesës për familjen e subjektit të rivlerësimit janë përlllogaritur jo në përputhje me shkresën nr. {***} prot., datë 04.03.2019, të ILDKPKI-së, si standard i përdorur edhe nga Kolegji në vendimet e mëparshme, duke ndikuar rrjedhimisht edhe në rezultatin financiar të këtij viti.

32.4. Sa i takon zërit “Shpenzimet e udhëtimit”, sipas Komisionerit Publik, përlllogaritjet e këtij zëri shpenzimesh, referuar raportit të hyrje-daljeve sipas sistemit TIMS, deklarimeve të subjektit në përgjigjet e pyetësorëve të Komisionit dhe deklaratave periodike vjetore, vlerësuar sipas

¹⁰ Me shkresën nr. {***} prot., datë 09.02.2021.

¹¹ Komisioneri Publik referon këtu vendimin e Kolegjit (JR) nr. 15/2021.

metodologjisë së vendimit orientues nr. 11/2019 (JR), datë 22.05.2019, të Kolegjit, do të rezultojnë me ndryshime nga përlllogaritjet e kryera prej Komisionit për vitet 2006, 2007, 2009 dhe 2013.

33. Në kuadër të debatit gjyqësor lidhur me qëndrimin e Komisionerit Publik dhe aktin e përgatitur në zbatim të vendimmarrjes së trupit gjykues, në kontekst të shkaqeve të ankimit të ngritura lidhur me zërat e analizës financiare, subjekti i rivlerësimit, znj. Iliba Bezati, prapësoi si vijon.

33.1. Në lidhje me zërin “Kursime ndër vite”, subjekti pretendoi se, nga mënyra se si ka kryer deklarimet e saj lidhur me likuiditetet ndër vite, duket qartë se likuiditetin në depozita bankare e ka trajtuar të ndarë nga likuiditeti i lirë (i disponueshëm në çdo kohë), duke deklaruar në datën 31 dhjetor të çdo viti, gjendjen e likuiditeteve në depozitat bankare si zë më vete dhe të likuiditeteve të lira që gjenden në banesë dhe në llogari rrjedhëse, si zë të veçantë, të quajtur “Kursime të vitit”. Sipas subjektit të rivlerësimit, ky konceptim i “kursimit të vitit”, ka qenë i njëjtë dhe koherent në çdo deklarim të saj. Subjekti prapësoi se deklarimet e saj lidhur me kursimet në vitet 2005-2009, nuk janë të ndryshme nga deklarimi i tyre në vitin 2010 e në vijim. “Kursimet e vitit”, sipas saj, janë konceptuar në të njëjtën mënyrë edhe në këtë periudhë, por për shkak se kursimet e secilit vit kanë shërbyer për kryerje pagesash/shlyerje detyrimesh, të cilat, siç rezultojnë nga aktet e administruara, janë kryer në fund të secilit vit, këtë kursim të përdorur ka vlerësuar ta evidentojë në deklaratat periodike për vitet 2006 dhe 2007 me shprehjen “vlera e shtuar dhe njëkohësisht e pakësuar”. Për këtë arsye, gjendja e *cash*-it në banesë dhe e mjeteve monetare të lira në llogaritë rrjedhëse, ka rezultuar, sipas saj, në fund të secilit prej këtyre viteve, në vlera të papërfillshme, shkak për të cilin ajo nuk e ka vlerësuar të arsyeshme për ta evidentuar në deklaratat periodike. Subjekti shprehet se në këtë periudhë, 2005 – 2009, çdo vit pasardhës ka hyrë me mbartje shumë të vogla mjeteve monetare të lira nga kursimet e vitit paraardhës, në ndryshim nga vitet e periudhës 2010-2016, në të cilat gjendja e mjeteve monetare të lira në llogaritë rrjedhëse dhe ajo *cash* në banesë ka rezultuar me vlera të konsiderueshme në fund të çdo viti.

33.2. Subjekti pretendoi gjithashtu se, nga shqyrtimi i analizës financiare të paraqitur nga Komisioneri Publik, bashkëlidhur parashtrimeve të datës 03.07.2024, rezultojnë se ai ka gjetur të drejtë vlerësimin e Komisionit (duke mos ngritur pretendime) se zëri “Kursimi i vitit”, i deklaruar në DPV-të vjetore, përfshin likuiditetin në *cash* + likuiditetin në llogari rrjedhëse, pa përfshirë likuiditetin në depozitat e kursimit, për sa kohë, sipas saj, vlerat e vendosura në zërat “Ndryshim likuiditeti” dhe “Total likuiditete”, në vitet 2006-2012, në analizën e tij paraqiten identike me ato të përfshira në analizën e Komisionit. Për rrjedhojë të sa më sipër, sipas subjektit të rivlerësimit, nuk është logjike që vetëm për vitin 2013, të mos gjendet i bazuar deklarimi i saj mbi kursimet familjare të këtij viti. Togfjalëshi “*cash*, të padepozituara në asnjë bankë”, i përmendur vetëm një herë, në një seksion të DPV-së së vitit 2013, sipas subjektit të rivlerësimit, i pambështetur nga asnjë e dhënë tjetër, nuk mund të zhbëjë tërësinë e të gjitha të dhënave të tjera mbi të vetmen mënyrë konceptimi nga ana e saj, të kursimeve të vitit.

33.3. Sipas subjektit të rivlerësimit, bazuar në analizën financiare të Komisionit, por edhe atë të kryer nga Komisioneri Publik (ku viti 2014 nuk paraqitet me diferencë negative), rezultojnë se

subjekti dhe personi i lidhur me të kanë pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për krijimin e depozitës në FiBank, për rrjedhojë, sipas saj, pasaktësia në mënyrën e deklarimit në vitin 2013, është e karakterit formal dhe pa pasoja në procesin e rivlerësimit.

34. *Në lidhje me zërin “Të ardhura të subjektit dhe bashkëshortit”, subjekti i rivlerësimit, znj. Iliba Bezati, prapësoi se nuk ka asnjë mospërputhje mes të ardhurave nga paga dhe honorarëve për vitet 2005, 2009 dhe 2010, të përfituara nga bashkëshorti i saj nga Universiteti “{***}”, Vlorë, referuar shkresës së këtij institucioni¹² të arsimit të lartë dhe akteve të tjera në dosje, pasi përmbajtja e kësaj shkrese vjen si nevojë për të plotësuar informacionin e marrë më parë nga i njëjti institucion¹³, në të cilin pasqyrohej vetëm një pjesë e honorarëve të përfituar në vitin 2005 nga bashkëshorti i saj dhe, konkretisht, vetëm ata për vitin akademik 2004-2005. Rrjedhimisht, në shkresën me nr. {***}, datë 09.02.2021, janë pasqyruar honorarët për pjesën e mbetur të vitit akademik 2005¹⁴, si dhe për vitet 2006¹⁵, 2009¹⁶, 2010¹⁷ dhe 2015¹⁸. Sipas subjektit, vlera e honorarëve për vitin 2005, është paguar *cash* nga arka e Universitetit të Vlorës deri në muajin prill 2005 dhe, nga kjo periudhë e në vazhdim, pagesat janë kryer në llogarinë bankare të bashkëshortit të subjektit në Raiffeisen Bank ShA. Subjekti pretendoi se bashkëshorti i saj ka përfituar të ardhura neto nga paga, mbingarkesa orare dhe shpërblime si anëtar i këshillit të universitetit, në shumën totale prej 1.051.981 lekësh, të cilat janë të dokumentuara. Sa i takon pretendimit të Komisionerit Publik mbi mospërlllogaritjen në zërin e të ardhurave të pagesave në formën e dietave për udhëtime jashtë shtetit, subjekti i rivlerësimit prapësoi se këto vlera janë përjashtuar nga zëri i të ardhurave, por janë përfshirë në analizën e Komisionit në kuadër të vlerësimit të shpenzimeve të udhëtimit, duke u konsideruar si të rimbursuara nga institucioni.*
35. *Sa u përket të ardhurave nga qiradhënia e apartamentit të banimit në Tiranë, për vitet 2011-2015, dhe të ardhurave nga shitja e librit të bashkëshortit në vitin 2011, subjekti i rivlerësimit kundërshtoi si të pabazuar pretendimin e Komisionerit Publik se këto të ardhura nuk plotësojnë standardin kushtetues dhe ligjor të së ardhurës së ligjshme për faktin se detyrimet tatimore janë përmbushur me vonesë, vetëm në janar të vitit 2017, para dorëzimit të deklaratës së pasurisë *vetting*. Subjekti i rivlerësimit pretendoi se, referuar qëndrimit orientues të Kolegjit në vendimin (JR) 15/2021 dhe fakteve që kanë rezultuar nga hetimi administrativ, rezulton se në rastin e të ardhurave të realizuara nga dhënia me qira e apartamentit: (i) provohet bindshëm ekzistenca e të ardhurave në kohën e krijimit të tyre dhe, në këtë aspekt, nuk ngrihet asnjë pretendim nga Komisioneri Publik; (ii) për këto të ardhura, rezultojnë të jenë paguar detyrimet tatimore përpara plotësimit të deklaratës *vetting*, në përputhje me parashikimet e nenit D, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 3, pika 19 e ligjit nr. 84/2016.*

¹² Me shkresën nr. {***} prot., datë 09.02.2021.

¹³ Sipas shkresës nr. {***}, datë 19.02.2020, të Universitetit të Vlorës.

¹⁴ Në shumën 230.429 lekë.

¹⁵ Shpërblime për këtë vit, në shumën 91.800 lekë.

¹⁶ Shpërblime për këtë vit, në shumën 138.925 lekë.

¹⁷ Shpërblime për këtë vit, në shumën 207.800 lekë.

¹⁸ Shpërblime për këtë vit, në shumën 61.200 lekë.

36. Subjekti parashtroi se të ardhurat nga qiraja e apartamentit të banimit në Tiranë, për vitet 2011-2015, sipas kontratës së lidhur nga bashkëshorti, dhe të ardhurat nga shitja e librit të bashkëshortit në vitin 2011, janë përfituar *cash* prej tij dhe se ajo nuk ka qenë në dijeni të mospagimit të detyrimeve tatimore në kohë, prej tij. Subjekti pretendoi se ka konstatuar mospagimin e detyrimit tatimor lidhur me këto të ardhura, vetëm gjatë periudhës së përgatitjes së deklaratës së pasurisë *vetting*, duke i kërkuar bashkëshortit pagesën e këtij detyrimi, i cili është përmbushur përpara dorëzimit të deklaratës së pasurisë *vetting*. Subjekti pretendoi se kjo situatë ka ardhur si pasojë e mungesës së kulturës së mjaftueshme financiare, edhe për shkak të mosparashikimit në kontratë në mënyrë të shprehur se cila prej palëve kontraktuale do të paguante detyrimin përkatës. Por, në çdo rast, ajo pretendoi se nuk ka qenë në kushte keqbesimi dhe as bashkëshorti i saj në kufijtë e kryerjes së një vepre penale.
37. Në kundërshtim të pretendimit të Komisionerit Publik për përlllogaritje të gabuar të shpenzimeve të jetesës për vitin 2007, subjekti i rivlerësimit, znj. Iliba Bezati, u shpreh se mbështet analizën financiare të Komisionit dhe llogaritjen e këtij zëri si një mesatare të ponderuar të konsumit të vitit 2006 dhe vitit 2008, dhe pretendoi se një llogaritje ndryshe e këtyre shpenzimeve, sipas pretendimit të Komisionerit Publik, nuk do të përkonte me realitetin dhe do të krijonte një disbalancë të pajustificuar brenda tri viteve të njëpasnjëshme (2006, 2007 dhe 2008), ndërkohë që, sipas saj, treguesit e familjes dhe nevojat e jetesës kanë qenë të pandryshuara, për më tepër kur fëmijët e saj në atë vit kanë qenë të moshave 4 dhe 7 vjeç.
38. Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi si të pabazuar edhe pretendimin tjetër të Komisionerit Publik në lidhje me zërin e shpenzimeve të udhëtimit dhe prapësoi se përlllogaritjet e kryera nga Komisioni janë të sakta dhe të vlerësuar mbi bazën e lëvizjeve sipas të dhënave të sistemit TIMS, si dhe të bazuara në metodologjinë e përdorur nga Kolegji, sipas jurisprudencës së tij orientuese në këtë drejtim.
39. Në përfundim të hetimit gjyqësor, gjatë fazës së bisedimeve përfundimtare, Komisioneri Publik mbajti qëndrimin e tij përfundimtar lidhur me këtë shkak të ankimit, sipas të cilit: *Bazuar në nenin 45, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, në përputhje me jurisprudencën e deritanishme të Kolegjit për të zbatuar çdo skenar të mundshëm garantist, me qëllimin për të vlerësuar të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e kontrollit të pasurive, si dhe bazuar në faktet që kanë rezultuar të provuara nga aktet në dosje, Komisioneri Publik vlerëson të marrë në konsideratë prapësimet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, lidhur me mënyrën e deklarimit të kursimeve cash në deklaratat periodike vjetore, përfshirë vitin 2013. Ndërsa, lidhur me të ardhurat e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit nga dhënia me qira e apartamentit në Tiranë dhe nga shitja e librit “{***}”, shpenzimet e jetesës për vitin 2007, përjashtimin e të ardhurave të përfituara në formën e dietave, si dhe për shpenzimet e udhëtimit për vitet 2006, 2007, 2009 dhe 2013, Komisioneri Publik rikonfirmoi qëndrimin e tij sipas ankimit dhe parashtrimeve në seancat gjyqësore publike para trupit gjykues. Sipas Komisionerit Publik, bazuar në sa më sipër, subjekti i rivlerësimit rezulton me mungesë të burimeve financiare të ligjshme në shumën e rreth 3,6*

milione lekëve për të mbuluar shpenzimet dhe kursimet e deklaruar ndë vite, vlerë kjo që, sipas tij, nuk mund t'i nënshtrohet parimit të proporcionalitetit, parashikuar nga neni 52, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe referuar standardit të vendosur nga jurisprudenca e deritanishme e Kolegjit.

40. Në kuadër të shqyrtimit të këtij shkaku ankimi, nga analizimi i akteve të fashikullit të krijuar gjatë hetimit administrativ të kryer në Komision dhe hetimit gjyqësor në Kolegj, si dhe pasi çmoi të gjitha pretendimet e palëve të parashtruara gjatë seancave gjyqësore publike, në konsideratë edhe të qëndrimit të mësipërm të Komisionerit Publik, duke hequr dorë nga pretendimet e ngritura fillimisht në ankim lidhur me zërin “Kursimet e vitit”, trupi gjykues konstatoi dhe vlerësoi si më poshtë.
41. Sa i takon pretendimit të Komisionerit Publik lidhur me mospërfshirjen e të ardhurave të krijuara me burim *nga qiradhënia e apartamentit të banimit në Tiranë, për vitet 2011-2015*, në total shuma prej 2.400.000 lekësh, si dhe të ardhurat *nga shitja e librit të bashkëshortit “{***}” në vitin 2011*, në shumën e 365.000 lekëve, me arsyetimin se detyrimet tatimore rezultojnë të jenë paguar në datën 24.01.2017, nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, vetëm 6 ditë para dorëzimit të deklarates së pasurisë *vetting* më datë 30.01.2017, dhe se pagesa të tilla në praktikën e Kolegjit janë konsideruar si të kryera për efekt të procesit të rivlerësimit, trupi gjykues, pasi verifikoi aktet e fashikullit të çështjes, konstatoi si më poshtë.
42. Bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, lidhur me dy marrëdhëniet kontraktuale të materializuara respektivisht sipas: (i) kontratës noteriale të qirasë nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 13.06.2010, të lidhur nga z. L. B. dhe z. A. F. përpara noterit A. Xh., me objekt dhënien me qira të apartamentit me sipërfaqe 121,6 m², në rrugën “{***}”, Tiranë, për një afat të pacaktuar kohor, me çmim qiraje 50.000 lekë në muaj; dhe (ii) kontratës së porosisë (shkresë e thjeshtë), e lidhur më datë 05.09.2011, nga z. L. B. në cilësinë e porositësit dhe Personi Fizik A. D. me NIPT {***}, me objekt shitja e librit universitar “{***}”, përkundrejt çmimit prej 1.500 lekësh për libër – pagesën e tatimit mbi të ardhurat e realizuara respektivisht nga qiraja dhe të drejtat e autorit, sipas parashikimeve të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, rezulton t'i ketë shlyer më datë 24.01.2017, në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar, si me të drejtë pretenduar nga Komisioneri Publik dhe pranuar fakti edhe nga subjekti i rivlerësimit.
43. Trupi gjykues vëren gjithashtu se pagesa e tatimit mbi të ardhurat e krijuara sipas kontratave të mësipërme, provohet sipas lëvizjeve të llogarisë së bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit pranë Bankës Kombëtare Tregtare, nëpërmjet transfertave të kryera në favor të degës së tatimeve, me përshkrimet: “DIVA likuiditet 11-A 2011 janar - dhjetor”, “Diva likuiditet 12-A 2012 janar - dhjetor”, “Diva likuiditet 13-A 2013 janar - dhjetor”, “Diva likuiditet 14-A 2014 janar - dhjetor”, “Diva likuiditet 15-A 2015 janar - dhjetor”, si dhe është reflektuar përkatësisht në formularët përkatës të deklarates individuale të të ardhurave, ku rezultojnë të jenë deklaruar vlerat e realizuara nga dy marrëdhëniet e sipërcituara kontraktuale, më konkretisht vlerat prej 600.000 mijë lekësh për periudhën 2011-2015, si të ardhura nga qiraja, në total shuma prej 3.000.000 lekësh (bruto) dhe vlera prej 350.000 lekësh, si të ardhura nga të drejtat e autorit.

44. Në kuadër të shqyrtimit të këtij shkaku ankimi, i cili lidhet me verifikimin nëse të ardhurat objekt kontrolli plotësojnë apo jo standardin kushtetues për t'u konsideruar të ardhura të ligjshme, në kushtet kur vihet në diskutim vetëm përmbushja e kriterit të pagesës së detyrimeve tatimore (në kontekstin e kohës dhe qëllimit të pagesës së kryer), në kushtet e konfirmimit të ligjshmërisë së burimit të tyre, trupi gjykues, duke vlerësuar me objektivitet rrethanat faktike të çështjes konkrete dhe sipas parimit të proporcionalitetit, arriti në përfundimin se pagimi me vonesë i detyrimeve tatimore për këto të ardhura nga personi i lidhur (bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit), në datën 24.01.2017, para se subjekti i rivlerësimit të depozitonte deklaratën e pasurisë *vetting*, në zbatim të nenit 31, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, nuk cenon standardin e të ardhurës së ligjshme, sipas përcaktimit të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, në drejtim të shlyerjes së detyrimeve tatimore.
45. Trupi gjykues arriti në këtë konkluzion pas shqyrtimit të kujdesshëm të fakteve dhe rrethanave konkrete të kësaj çështjeje, të analizuara edhe në dritën e orientimit të dhënë nga Kolegji në vendimin e tij orientues nr. (JR) 15/2021, sipas së cilës vlerësoi se për marrëdhënien e qiradhënies së apartamentit në Tiranë, e cila kishte shërbyer për krijimin e pjesës më të konsiderueshme të së ardhurës objekt kontrolli, personi i lidhur (bashkëshorti i subjektit) e kishte materializuar këtë marrëdhënie me palën qiramarrëse përpara noterit publik, nëpërmjet një akti noterial (dhe jo një shkrese të thjeshtë), çka u vlerësua nga trupi gjykues si një tregues domethënës në drejtim të mungesës së një qëllimi për t'u arritur prej tij në vitin 2011 dhe në vazhdim, të mospagesës së tatimit lidhur me të ardhurat e realizuara nga kjo marrëdhënie. Gjithashtu, sjellja e subjektit të rivlerësimit për marrjen e përgjegjësive të plota nëpërmjet bërjes transparente të situatës së saj (lidhur me mospërmbushjen në kohë të detyrimit për pagesë, sipas legjislacionit të zbatueshëm), në raport me organet tatimore, si dhe me institucionet e rivlerësimit para nisjes së procesit të rivlerësimit, u çmua nga trupi gjykues se vendos kufirin ndarës në vlerësimin e subjekteve që kanë treguar një nivel përgjegjshmërie mes subjekteve që detyrimet tatimore lidhur me të ardhurat e krijuara, i kanë përmbushur me vonesë, në kuadër të nevojave të procesit të rivlerësimit.
46. Për rrjedhojë, në përfundim të sa më sipër, trupi gjykues arriti në përfundimin për konsiderimin si të ardhura të ligjshme, në kuptim të standardit kushtetues dhe ligjor, të të ardhurave të krijuara nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit nga dhënia me qira e apartamentit të banimit në Tiranë, për periudhën 2011-2015, si dhe nga shitja e librit universitar “{***}”, në vitin 2011.
47. Në lidhje me pretendimin e Komisionerit Publik në drejtim të përlllogaritjes së gabuar nga ana e Komisionit, të shpenzimeve të jetesës për vitin 2007, trupi gjykues e gjeti të drejtë dhe të bazuar këtë pretendim të Komisionerit Publik, në harmoni edhe me jurisprudencën e deritanishme të Kolegjit, sipas së cilës shpenzimet e jetesës edhe për vitin 2007, duhen përlllogaritur sipas standardit të ILDKPKI-së, bazuar në të dhënat e INSTAT-it¹⁹, si të dhëna të standardizuara, sa më sipër në përputhje edhe me parashikimet e nenit 49, pika 4 e ligjit nr. 84/2016. Për rrjedhojë, ky

¹⁹ Sipas shkresës nr. {***} prot., datë 05.05.2008, në të cilën përcaktohet se konsumi vjetor për frymë është në vlerën 235.968 lekë dhe, rrjedhimisht, shpenzimet e jetesës për familjen e subjektit të rivlerësimit u përlllogaritën në vlerën 943.872 lekë.

konkluzion u mbajt në konsideratë nga trupi gjykues edhe gjatë vlerësimit të zërit përkatës të analizës financiare të këtij viti.

48. Sa i takon pretendimit të Komisionerit Publik në lidhje me nevojën për rillogaritjen e shpenzimeve të udhëtimit jashtë vendit, në përputhje me metodologjinë e Kolegjit, të përcaktuar në vendimin e tij (JR) nr. 11/2019, si dhe korrigjimin e zërit të të ardhurave (paga, honorarë dhe dieta) në lidhje me verifikimin e shumave të përfituara në formën e pagave dhe honorarëve, dhe mospërfshirjen në këtë zë të vlerave monetare të përfituara në formën e dietave nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues, pasi kreu verifikimet e nevojshme lidhur me saktësinë e përllogaritjes së këtyre zërave nga Komisioni, konstatoi se pasaktësitë e Komisionit të vërejtura në lidhje me zërat e analizës financiare “Të ardhura të subjektit dhe bashkëshortit”²⁰ dhe “Shpenzimet e udhëtimit”²¹, rezultuan pa ndonjë peshë në rezultatin e analizës financiare të viteve përkatëse.
49. Në përfundim të analizës së kryer mbi shqyrtimin e shkaqeve të ankimit për vlerësimin e kriterit të pasurisë, në vijim të konkluzioneve të arritura më sipër në këtë vendim, lidhur me çështjet e ngritura nga Komisioneri Publik, pasi kontrolloi analizën financiare të kryer nga Komisioni për periudhën 2003-2016, nëpërmjet Njesisë së Shërbimit Ligjor, nga ku rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të kanë mungesë të burimeve të ligjshme për krijimin e pasurive dhe kryerjen e shpenzimeve në shumën prej 1.145.886 lekësh, trupi gjykues arriti në konkluzionin se ky rezultat negativ, në vlerësim të situatës faktike specifike të çështjes objekt gjykimi, sipas parimeve të objektivitetit dhe proporcionalitetit, nuk e cenon besueshmërinë e subjektit të rivlerësimit, lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë.
50. Në këto kushte, trupi gjykues çmoi se subjekti i rivlerësimit, znj. Iliba Bezati, ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë së saj dhe të personave të lidhur me të, në kuptim të parashikimeve të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 59, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016.

C. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit lidhur me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale

51. Në lidhje me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, Komisioneri Publik pretendoi se lidhur me shqyrtimin e një ankese me nr. {***} prot., datë 24.06.2014, të përmendur në raportin e organit ndihmës, në kapitullin “Të dhëna arkivore të KLD-së”, informacion nga kryetarja e Gjykatës së

²⁰ Në lidhje me zërin “të ardhurat nga paga dhe honorarë”, nga kontrolli i kryer nga Njësia e Shërbimit Ligjor, u konstatua se Komisioni kishte përllogaritur për vitet 2009 dhe 2010, totalin e pagave dhe honorarëve në një vlerë më të lartë, përkatësisht në vlerat 1.220 lekë dhe 85.227 lekë. Në vlerën prej 85.227 lekësh, të përllogaritur nga Komisioni për vitin 2010, u konstatua se ishte përfshirë edhe vlera prej 31.466 lekësh, e përfituar në datën 25.03.2010, me përshkrimin: “Universiteti {***}, Dieta”, e cila u korrektua, në përputhje me qëndrimin orientues për mosvlerësimin e dietave në zërin e të ardhurave. Konstatimi i Komisionerit Publik në analizën financiare të paraqitur prej tij në këtë zë të ardhurash, për vitin 2012, për një përllogaritje nga Komisioni, me një vlerë më të ulët prej 77.499 lekësh, u gjet i saktë dhe u korrektua përkatësisht.

²¹ Nga kontrolli i kryer nga Njësia e Shërbimit Ligjor, u konstatua se për shpenzimet e udhëtimit, përllogaritjet e Komisionit rezultuan me pasaktësi për vitet 2006, 2007 dhe 2009, përkatësisht në vlerat 2.624 lekë, 4.067 lekë dhe 7.737 lekë, në total 14.428 lekë më pak.

Apelit Vlorë, mbi cenimin e vendimit nr. 181, datë 19.09.2013, të Gjykatës së Apelit Vlorë me vendimin nr. 339, datë 18.12.2013, të Gjykatës së Lartë, referuar përmbajtjes së vendimit, në vlerësimin e tij, qëndrimi i Komisionit për këtë çështje është ometuar dhe, për pasojë, ai nuk ka analizuar pretendimet e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit në raport me përmbajtjen e dispozitave të neneve 245-249 të Kodit të Procedurës Penale, referuar dhe vendimit të ndërmjetëm, datë 18.06.2013, që ka marrë vetë trupa gjykuese e Gjykatës së Apelit Vlorë.

52. Sipas Komisionerit Publik, Komisioni nuk ka analizuar faktin se nga aktet në dosje, rezulton se në fletëthirrjet e dërguara nga Gjykata e Apelit, Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe fletëthirrjes së dërguar në banesën e shtetasit M.Rr., për zhvillimin e seancës, fletëthirrje që mbajnë datën 11.06.2013, gjenden respektivisht shënimet: “Nuk ndodhet në paraburgim”; “Larguar nga kjo adresë”, dhe se këto fletëthirrje janë pjesë e dosjes gjyqësore të administruar nga vetë subjekti i rivlerësimit.
53. Komisioneri Publik pretendoi se edhe pas shqyrtimit gjyqësor, mbeti e pandryshuar situata faktike dhe rrethanat e konstatuara, lidhur me vendimin penal nr. 181, datë 19.06.2013, të Gjykatës së Apelit Vlorë, për efekt të vlerësimit etik dhe profesional të subjektit të rivlerësimit dhe se ky rast duhet vlerësuar nga Kolegji në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.
54. Subjekti i rivlerësimit, znj. Iliba Bezati, në kundërshtimin e këtij shkaku të ankimit, prapësoi se *ometimi* i pretenduar në ankim, nuk sjell për pasojë as cenimin e standardit të arsytimit të vendimit objekt kontrolli, por as konkluzionin e Komisionit lidhur me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, për rrjedhojë, sipas saj, vendimi edhe për këtë pjesë duhet të lihet në fuqi.
55. Në mbështetje të sa më sipër, subjekti i rivlerësimit parashtroi para trupit gjykues se, nga tërësia e akteve të dosjes penale objekt shqyrtimi, vendimi gjyqësor i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë nr. 288, datë 29.05.2013, i cili kishte deklaruar ikjen e shtetasit M. Rr., nuk ishte administruar në asnjë shkallë gjykimi, jo vetëm në gjykimin në shkallë të parë (pasi ishte dhënë 5 ditë pas dhënies së vendimit të gjykatës së shkallës së parë për caktimin e masës së sigurimit), por nuk gjendej as në aktet e shqyrtuara në shkallë të dytë, pasi ky vendim nuk ishte paraqitur nga Prokurori i Apelit, as ishte përmendur prej tij përpara Gjykatës së Apelit Vlorë apo në rekursin e ushtruar ndaj këtij vendimi në vijim. Gjithashtu, subjekti pretendoi se prokuroria nuk kishte paraqitur as akte procedurale që të evidentonin pamundësinë e komunikimit të vendimit të caktimit të masës së sigurimit “Arrest në burg” personit nën hetim dhe shkakun që ky person ishte larguar apo nuk gjendej në atë adresë dhe as aktet procedurale për zbatimin e masës së sigurimit apo procesverbalin për kërkimin e personit që nuk gjendej. Si rrjedhojë e këtyre fakteve, subjekti i rivlerësimit pretendoi se Gjykata e Apelit Vlorë, konkretisht trupi gjykues ku ajo ishte në cilësinë e anëtares, nuk kishte asnjë mundësi të merrte dijeni për ekzistencën e këtij vendimi. Aktet procedurale që do të vërtetonin ekzistencën e kësaj rrethane edhe pas gjykitimit të çështjes në shkallë të dytë apo që do të vërtetonin zbatimin e masës së sigurimit dhe ecurinë e hetimeve deri në momentin e shqyrtimit të çështjes në Gjykatën e Lartë, sipas pretendimit të subjektit të rivlerësimit, nuk janë bërë të ditura as në gjykimin në Gjykatën e Lartë.

56. Subjekti pretendoi gjithashtu se prokurori i apelit, rrezikshmërinë e të dyshuarit e ka lidhur vetëm me natyrën e veprës penale dhe sanksionin e parashikuar nga ligjvënësi për këtë vepër penale dhe jo me rrethana konkrete fakti që do të vërtetonin se mungesa e tij në gjykatën e apelit kishte për qëllim fshehjen nga drejtësia.
57. Për më tepër, subjekti parashtroi se fakti që ka qenë anëtare e trupit gjykues në këtë çështje, dhe jo relatore e çështjes, duhet të mbahet në konsideratë, duke qenë se, sipas dispozitave procedurale penale, kjo e fundit ngarkohet me përgjegjësinë për relatimin e çështjes, jo vetëm mbi bazën e provave të administruara në dosje, por edhe mbi bazën e përmbajtjes së akteve procedurale, për aq vlerë provuese që ato mund të kenë, siç është në rastin konkret përmbajtja e fletëthirrjeve për personin nën hetim.
58. Nga shqyrtimi i këtij pretendimi të Komisionerit Publik, pas verifikimit të akteve të fashikullit të çështjes, përmbajtjes së shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit në kuadër të barrës së provës mbi rezultatet e hetimit administrativ, si dhe arsyetimit të Komisionit në vendimin e tij, trupi gjykues vëren se, sikundër me të drejtë pretendoi edhe Komisioneri Publik në ankim, Komisioni nuk ka arsyetuar në lidhje me shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit lidhur me çështjen e sipërcituar. Konstatohet se në vijim të paraqitjes së: (i) situatës faktike lidhur me informacionin e kryetares së Gjykatës së Apelit Vlorë mbi cenimin e vendimit nr. 181, datë 19.06.2013, të Gjykatës së Apelit Vlorë²², ku subjekti ka qenë në cilësinë e anetares së trupit gjykues, çështje kjo e përfshirë në “Të dhënat arkivore të KLGj-së” dhe e referuar në raportin e vlerësimit të aftësive profesionale të përgatitur nga kjo e fundit, si çështje e evidentuar për efekt të vlerësimit profesional dhe etik të gjyqtarës Iliba Bezati; (ii) hetimit të kryer nga Komisioni; si dhe (iii) shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit, si parashtruar edhe në ankimin e Komisionerit Publik²³, Komisioni, në rubrikën “Vlerësimi i trupit gjykues”, duket të jetë shprehur në mënyrë konkrete vetëm në lidhje me ankesën e vitit 2015, të përmendur në raportin e KLGJ-së²⁴, dhe jo asaj të vitit 2014, duke arritur në konkluzionin se *nuk kanë rezultuar problematika lidhur me veprime apo mosveprime të subjektit të rivlerësimit, të cilat mund të konsistojnë apo ngrinin dyshime të mbështetura mbi shkelje procedurale, mangësi profesionale apo cenim të etikës së gjyqtarit*.
59. Pavarësisht sa më sipër konstatuar, në analizë të këtij shkakut ankimi, pasi dëgjoi parashtrimet e palëve në seancë gjyqësore, referuar edhe kërkit të Komisionerit Publik për trajtimin sipas parashikimeve të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, të vendimmarrjes së subjektit të rivlerësimit në vitin 2013 (në cilësinë e anetares së trupit gjykues që ka dhënë vendimin e ndërmjetëm të datës 19.06.2013), trupi gjykues vlerësoi se në lidhje me këtë çështje penale dhe përgjegjësitë e subjektit të rivlerësimit në këtë vendimarrje, analizuar këto në dritën e burimeve të vlerësimit të kriterit të

²² Shih paragrafët 199-203 në faqet 49-51 të vendimit të Komisionit.

²³ Shih paragrafin 18.4 në faqen 9 të ankimit të Komisionerit Publik, për më hollësisht referoju paragrafit 206 në faqet 53-54 të vendimit të Komisionit.

²⁴ Ankesa me nr. {***}, datë 2.6.2015, e shtetasve A. dhe A. Sh., e depozituar në KLD dhe e regjistruar në ILD me nr. {***} prot., datë 29.10.2020.

aftësive profesionale, referuar pikës 1 të nenit 42 të ligjit nr. 84/2016, të lexuar në harmoni me nenin 77 të ligjit nr. 96/2016, si dhe indikatorëve të vlerësimit sipas të njëjtit ligj, nuk konstatohen problematika të cilat do të cenonin konkluzionin e Komisionit lidhur me këtë kriter të rivlerësimit, apo lidhur me vlerësimin e përgjithshëm të subjektit të rivlerësimit për të tria kriteret e procesit të rivlerësimit kalimtar. Në këto kushte, trupi gjykues vlerëson se përfundimi i Komisionit lidhur me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, znj. Iliba Bezati, mbetet i pacenuar.

60. Për rrjedhojë, trupi gjykues, në vijim të konkluzioneve të mësipërme, bazuar në nenin 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, vlerësoi se vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, është i bazuar në fakte dhe në ligj dhe, për rrjedhojë, duhet të lihet në fuqi.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 352, datë 01.03.2021, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Iliba Bezati.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, më datë 30.07.2024, në Tiranë.

ANËTARE

Ina RAMA

nënshkrimi

ANËTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi

ANËTARE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

RELATOR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

KRYESUESE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi